

# PHILIPS

**Kufje**

TAH8000E



## Manuali i Përdoruesit

Regjistroni produktin tuaj dhe përfitoni mbështetje në:

[www.philips.com/support](http://www.philips.com/support)

# Përmbajtja

|   |                                                          |    |
|---|----------------------------------------------------------|----|
| 1 | Udhëzime të rëndësishme<br>sigurie                       | 2  |
|   | Siguria e dëgjimit                                       | 2  |
|   | Informacion i përgjithshëm                               | 2  |
| 2 | Kufje tuaja mbi vesh me<br>anulim aktiv të zhurmës (ANC) | 4  |
|   | Çfarë ka në kuti                                         | 4  |
|   | Pajisje të tjera                                         | 4  |
|   | Veshtrim i përgjithshëm e kufjeve<br>tua me valë         | 5  |
| 3 | Fillo                                                    | 6  |
|   | Ngarkoni baterinë                                        | 6  |
|   | Ndërroni baterinë                                        | 6  |
|   | Shkarkoni aplikacionin                                   | 7  |
|   | Çiftoni kufjet me pajisjen tuaj                          |    |
|   | Bluetooth për herë të parë                               | 7  |
|   | Çiftoni kufjet me një pajisje tjetër                     |    |
|   | Bluetooth                                                | 8  |
|   | Lidhje me shumë pika                                     | 8  |
|   | Lidhni kufjet me pajisjen tuaj                           |    |
|   | përmes kablos audio 3,5 mm                               | 8  |
| 4 | Përdorni kufjet tuaja                                    | 9  |
|   | Lidhni kufjet me pajisjen tuaj                           |    |
|   | Bluetooth                                                | 9  |
|   | Ndiz/Fik                                                 | 9  |
|   | Kontrollo ANC (Anulimi i Zhurmës                         |    |
|   | Aktive)                                                  | 9  |
|   | Menaxhoni telefonatat dhe                                |    |
|   | muzikën tuaj                                             | 10 |
|   | Asistenti zanor                                          | 10 |
|   | Statusi i treguesit LED të kufjeve                       | 11 |
| 5 | Rivendosni kufjet                                        | 12 |
| 6 | Të dhënat teknike                                        | 12 |

|   |                            |    |
|---|----------------------------|----|
| 7 | Njoftim                    | 13 |
|   | Deklarata e konformitetit  | 13 |
|   | Asgjësimi i produktit dhe  |    |
|   | baterisë tuaj të vjetër    | 13 |
|   | Hiqni baterinë e integruar | 13 |
|   | Pajtueshmëria me EMF       | 13 |
|   | Informacion mjedisor       | 13 |
|   | Njoftimi i pajtueshmërisë  | 14 |
| 8 | Markat tregtare            | 15 |
| 9 | Pyetjet e bëra shpesh      | 15 |

# 1 Udhëzime të rëndësishme sigurie

## Siguria e dëgjimit



### Rrezik

- Për të shmangur dëmtimin e dëgjimit, kufizoni kohën e përdorimit të kufjeve me volum të lartë dhe vendoseni volumin në një nivel të sigurt. Sa më i lartë të jetë volumi, aq më e shkurtër duhet të jetë koha e sigurt e dëgjimit.

Sigurohuni që të respektoni udhëzimet e mëposhtme gjatë kohës që përdorni kufjet tuaja.

- Dëgjoni me volum të pranueshëm për periudha të arsyeshme kohore.
- Kini kujdes që të mos e ngrini vazhdimisht volumin gjatë kohës që dëgjimi juaj është duke u përshtatur.
- Mos e ngrini shumë volumin sa të mos dëgjoni as se çfarë bëhet rreth jush.
- Duhet të kini kujdes ose të ndërpritni përkohësisht përdorimin në situata potencialisht të rrezikshme.
- Presioni i tepërt i zërit nga kufjet aurikolare dhe kufjet që mbahen në kokë mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.
- Nuk rekomandohet përdorimi i kufjeve me të dy veshët e zënë gjatë ngarjes së makinës dhe mund të jetë i paligjshëm në disa zona.
- Për sigurinë tuaj, shmangni shpërqendrimet nga muzika ose telefonatat kur jeni në trafik ose mjedise të tjera potencialisht të rrezikshme.

## Informacion i pergjithshem

Për të shmangur dëmtimin ose mosfunksionimin:



### Kujdes

- Mos i ekspozoni kufjet ndaj nxehtësisë së tepërt.
- Mos i hidhni kufjet në tokë.
- Kufjet nuk duhet të ekspozohen ndaj pikimit ose spërkatjes. (Referojuni vlerësimit IP të produktit specifik)
- Mos lejoni që kufjet tuaja të zhyten në ujë.
- Mos i karikoni kufjet kur lidhësi (konektori) ose priza janë të lagura.
- Mos përdorni asnjë agjent pastrimi që përmban alkool, amoniak, benzen ose lëndë gërryese.
- Përdorni një leckë të pastër dhe të lagur për të pastruar rregullisht kufjet tuaja - veçanërisht kanalet e zërit dhe vrimëzat e mikrofonit - dhe shmangni grumbullimin e substancave të tilla si djersa ose dylli i veshit.
- Nëse në kanalet e zërit, vrimat e ajrit ose vrimëzat e mikrofonit mbeten pikëza djerse ose uji, niveli i zërit do të ulet përkohësisht ose nuk do të ketë fare. Ky nuk është një keqfunksionim. Përdorni një leckë të butë dhe të lagur për të tharë plotësisht kufjet. Në të kundërt, hiqni majat e këllëfit të kufjeve, lëvizni kanalet e zërit me drejtim nga poshtë dhe prekni lehtë kufjet rreth pesë herë me një leckë të thatë ose me dicka të ngjashme për të hequr ujin r mundshëm të mbledhur në brendësi.
- Sigurohuni që kufjet të jenë plotësisht të thata përpara se t'i karikoni dhe përdorni. Shmangni përdorimin e tamponëve të alkoolit me një përdorim ose të substancave të tjera për pastrim.
- Bateria e integruar nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësisë së tepërt si ndaj rrezeve të diellit, zjarrit ose të ngjashme me to.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria është zëvendësuar gabimisht. Zëvendësoni vetëm me të njëjtin lloj ose ekuivalent me të.
- Për të arritur vlerësimin specifik IP, kapaku i folesë së karikimit duhet të mbyllet.
- Hedhja e një baterie në zjarr ose në një furrë të nxehtë, ose shtypja ose prerja mekanike e një baterie, mund të rezultojë në një shpërthim.
- Lënia e një baterie në një mjedis rrethues me temperaturë jashtëzakonisht të lartë mund të rezultojë në një shpërthim ose rrjedhje të lëngut apo gazit të ndezshëm.
- Një bateri që i nënshtrohet presionit jashtëzakonisht të ulët të ajrit mund të rezultojë në një shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit të ndezshëm.

- Zëvendësimi i një baterie me një lloj të gabuar rrezikon të dëmtojë rëndë kufjet dhe baterinë (për shembull, në rastin e disa llojeve të baterive litium).
- Nëse kufjet nuk përdoren për një kohë të gjatë, bateria e ringarkueshme do të nisë të humbë ngarkesën e saj. Për të shmangur këtë humbje, jeni të lutur të karikoni plotësisht baterinë të paktën një herë në tre muaj.
- Për të shmangur rrezikun e zjarrit, pajisja duhet të furnizohet vetëm nga një burim i jashtëm energjie, i cili duhet të jetë në përputhje me standardin PS1 (me kapacitet daljeje më të vogël ose të barabartë me 15W).

Lagështia dhe temperaturat e funksionimit dhe ruajtjes


- Ruajeni në një vend ku temperatura është midis  $-20^{\circ}\text{C}$  dhe  $50^{\circ}\text{C}$  me lagështi relative deri në 90%.
- Vëreni në funksionim në një vend ku temperatura është ndërmjet  $0^{\circ}\text{C}$  dhe  $45^{\circ}\text{C}$  me lagështi relative deri në 90%.
- Jetëgjatësia e baterisë mund të jetë më e shkurtër në kushte të temperaturës së lartë ose të ulët.

## 2 Kufje tuaja mbi vesh me anulim aktiv të zhurmës (ANC)

Urime për blerjen tuaj dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron Philips, regjistroni produktin tuaj në [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support). Me këto kufje Philips ju mund të:

- Argëtoheni me telefonatat e përshtatshme me valë pa përdorimin e duarve
- Shijoni dhe kontrolloni muzikën me valë
- Manovroni mes telefonatave dhe muzikës
- Gëzoni anulimin e zhurmës


### Çfarë ka në kuti




Kufje mbi vesh me anulim aktiv të zhurmës (ANC)  
**TAH8000E**



Kabllo karikimi USB (vetëm për karikim)



Çanta mbajtëse



Kabloja audio



Udhëzues për Fillimin e Shpejtë



Garancia Globale






Fletëpalosje sigurie

### Pajisje të tjera

Një telefon celular ose pajisje (p.sh. kompiuter, tablet, përshtatës Bluetooth, lexues MP3 etj) që mbështet Bluetooth dhe është i pajtueshëm me kufjet (shih 'Të dhënat teknike' në faqen 12).

## Veshtrim i përgjithshëm e kufjeve tuaja me valë



- ① Butoni i modalitetit të ndërgjegjësimit/ANC
- ② Butoni shumë funksional (MFB)
- ③ Butoni i furnizimit me energji
- ④ Treguesi LED
- ⑤ Vendi i caktuar për karikimin USB-C
- ⑥ Futës 3,5 mm për audio
- ⑦ Mikrofoni

## 3 Fillo

### Ngarkoni baterinë


#### Shënim

- Përpara se të përdorni kufjet tuaja, karikoni baterinë për 2 orë për kapacitet dhe jetëgjatësi optimale të baterisë.
- Përdorni vetëm kabllon origjinalë të karikimit USB-C për të shmangur çdo dëmtim.
- Përfundoni telefonatën tuaj përpara se ta vini në ngarkim. Lidhja e kufjeve me karikimin do t'i fikë ato.
- Nëse kufjet nuk përdoren për një kohë të gjatë, bateria e ringarkueshme do të nisë të humbë ngarkesën e saj. Për të shmangur këtë humbje, jeni të lutur të karikoni plotësisht baterinë të paktën një herë në tre muaj.

Lidhni kabllon USB të furnizuar për karikimin:

- Njëri skaj në vendin e karikimit USB-C në kufje;
- Skaji tjetër në portën e karikimit/USB të një kompjuteri.

↳ LED bëhet i bardhë gjatë karikimit dhe fiket kur kufjet ngarkohen plotësisht.




#### Këshillë

- Normalisht, një karikim i plotë kërkon 2 orë.

### Ndërroni baterinë

Bateria është e zëvendësueshme. Për të çmontuar mbulesën e kufjes së majtë dhe për të zëvendësuar baterinë, nevojitet një mjet special hapës.



#### Shënim

- Një mjet special hapës/i dedikuar për heqjen e baterisë është i nevojshëm. Ky mjet special do të ofrohet falas me blerjen e pjesës rezervë të baterisë.

## Shkarkoni aplikacionin

Skanoni kodin QR/shtypni butonin "Shkarko" ose kërkoni "Philips Headphones" në Apple App Store ose Google Play për të shkarkuar aplikacionin.



[philips.to/headapp](https://philips.to/headapp)

Aplikacioni i Philips Headphones ju jep kontrollin e muzikës që jeni duke dëgjuar. Mund ta personalizoni tingullin në mënyrë që përvoja juaj e muzikës dhe e telefonatave t'i përshtatet gjithmonë nevojave tuaja.

## Çiftoni kufjet me pajisjen tuaj Bluetooth për herë të parë

- 1 Sigurohuni që kufjet të jenë plotësisht të karikuara dhe të fikura.
- 2 Shtypni dhe mbani të shtypur butonin e ndezjes për 2 sekonda; kufjet do të kalojnë në modalitetin e çiftimit dhe do të jenë gati për t'u lidhur.
  - ↳ LED në kufje lëshon dritë pulsuese në ngjyrë të bardhë dhe blu në mënyrë të ndryshueshme.

↳ Kufjet janë aktualisht në modalitetin e çiftimit dhe janë gati për t'u çiftuar me një pajisje Bluetooth (p.sh. një telefon celular).

- 3 Aktivizoni funksionin Bluetooth të pajisjes suaj Bluetooth.
- 4 Çiftoni kufjet me pajisjen tuaj Bluetooth, referojuni manualit të përdorimit të pajisjes suaj Bluetooth.

### Shënim

- Pas ndezjes, nëse kufjet nuk mund të gjejnë asnjë pajisje Bluetooth të lidhur më parë, ju lutemi vendosini ato në modalitetin e çiftimit (shtypni butonin MFB për 5 sekonda pasi ta ndizni).
- Kufjet do të fiken automatikisht pas 5 minutash mungese aktiviteti me Bluetooth. Koha aktuale mund të ndryshojë në varësi të kushteve të përdorimit.

Shembulli i mëposhtëm ju tregon se si të çiftoni kufjet me pajisjen tuaj Bluetooth.


- 1 Aktivizoni funksionin Bluetooth të pajisjes suaj Bluetooth, zgjidhni **Philips TAH8000E**.
- 2 Futni fjalëkalimin e kufjeve "0000" (4 zero) nëse ju kërkohet. Për ato pajisje që kanë Bluetooth 3.0 e lart (modelet më të fundit), nuk ka nevojë të futni një fjalëkalim.



**Philips TAH8000E**

## Çiftoni kufjet me një pajisje tjetër Bluetooth

Nëse dëshironi të çiftoni një pajisje tjetër Bluetooth me kufjet, ndizni kufjet dhe më pas shtypni butonin MFB për 5 sekonda dhe zbuloni pajisjen e dytë si në çiftimin normal.



### Shënim

- Kufjet mund të ruajnë 5 pajisje në memorie. Nëse përpiqeni të çiftoni më shumë se 5 pajisje, pajisja e çiftuar në fillim (e para) zëvendësohet me një të re.

## Lidhje me shumë pika

Çiftimi

- Çiftimi i kufjeve me 2 pajisje, p.sh. celular dhe kompjuter.

Kalo nga një pajisje në tjetrën



- Në çdo kohë, mund të dëgjosh muzikë vetëm nga 1 pajisje. Pajisja tjetër do të jetë për thirrjet telefonike.
- Vër në pauzë audion nga njëra pajisje dhe më pas fillo riprodhimin e audios nga pajisja tjetër.

### Shënim

- Kur transmetohet audio nga Pajisja 1, marrja e një telefonate nga Pajisja 2 do të vërë automatikisht në pauzë riprodhimin nga Pajisja 1. Dhe telefonata do të drejtohet automatikisht në kufje.
- Përfundimi i telefonatës do të rifillojë automatikisht riprodhimin nga Pajisja 1.

## Lidhni kufjet me pajisjen tuaj përmes kablllos audio 3,5 mm

Kur bateria e kufjeve të jetë e shkarkuar ose nëse pajisjes suaj i mungon aftësia Bluetooth, ato mund të lidhen me pajisjen duke përdorur një kabllo për audio 3,5 mm.



## 4 Përdorni kufjet tuaja

### Lidhni kufjet me pajisjen tuaj Bluetooth

- 1 Aktivizoni funksionin Bluetooth të pajisjes suaj Bluetooth.
- 2 Shtypni dhe mbajeni shtypur butonin e furnizimit me energji për ta ndezur kufjen.
  - ↳ LED i bardhë do të ndizet për 2 sekonda
  - ↳ Kufjet rilidhen automatikisht me celularin/ pajisjen e fundit të lidhur me Bluetooth

#### Këshillë

- Nëse hapni funksionin Bluetooth të pajisjes suaj Bluetooth pas ndezjes së kufjeve, duhet të shkoni te menyja Bluetooth e pajisjes dhe t'i lidhni kufjet me pajisjen në mënyrë manuale.

#### Shënim

- Në disa pajisje Bluetooth, lidhja mund të mos jetë automatike. Në këtë rast, duhet të shkoni te menyja Bluetooth e pajisjes tuaj dhe t'i lidhni kufjet me pajisjen Bluetooth në mënyrë manuale.

### Ndiz/Fik


| Detyrë        | Buton                                                                               | Përdorimi                                                                         |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|
| Ndizni kufjet |  | Shtypeni dhe mbajeni shtypur për 2 sekonda                                        |
| Fikni kufjet  |  | Shtypeni dhe mbajeni të shtypur për 2 sekonda (LED i bardhë ndizet për 3 sekonda) |

## Kontrollo ANC (Anulimi i Zhurmës Aktive)

### Aktivizo ANC

Modalitetet e ndryshme të ANC mund të aktivizohen duke shtypur një herë butonin  në kufjen e djathtë.

- Funksioni ANC aktivizohet automatikisht kur kufjet vendosen në vesh.
- Shtypni butonin  një herë, kjo do të çaktivizojë funksionin ANC.
- Shtypni edhe një herë në butonin , do të kalohet në modalitetin e ndërgjegjësimit.



| Detyrë                       | Buton                                                                               | Përdorimi                                    |
|------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|
| ANC NDEZUR                   |  | Shtypni një herë                             |
| ANC FIKUR                    |  | Shtypni një herë                             |
| Modaliteti i ndërgjegjësimit |  | Shtypni një herë                             |
| Ndërgjegjësimi i shpejtë     |  | Shtypni dhe mbajeni të shtypur për 1 sekondë |

#### Shënim

- Kur është i ndezur dhe me bateri të ngarkuar, ky model mbështet Anulimin Aktiv të Zhurmës (ANC) si me lidhje valore nëpërmjet Bluetooth ashtu edhe me kablo nëpërmjet prizës 3,5 mm.

# Menaxhoni telefonatat dhe muzikën tuaj

## Kontrolli i muzikës

| Detyrë                 | Buton | Përdorimi                                        |
|------------------------|-------|--------------------------------------------------|
| Luaj ose ndalo muzikën | MFB   | Shtypje e vetme                                  |
| Kënga e mëparshme      | MFB   | Shtypni drejt te “-” dhe mbajeni për një sekondë |
| Kënga tjetër           | MFB   | Shtypni drejt te “+” dhe mbajeni për një sekondë |
| Rregulloni volumn +    | MFB   | Shtypni drejt te “+”                             |
| Rregulloni volumn -    | MFB   | Shtypni drejt te “-”                             |

## Shënim

- Do të lëshohet një sinjal akustik që tregon se kur volumni ka arritur nivelin maksimal.

## Kontrolli i thirrjeve telefonike

| Detyrë                                           | Buton | Përdorimi                                    |
|--------------------------------------------------|-------|----------------------------------------------|
| Ngri një telefonatë                              | MFB   | Shtypje e vetme                              |
| Mbyll telefonatën/<br>Refuzo thirrjen telefonike | MFB   | Shtypni dhe mbajeni të shtypur për 1 sekondë |

## Thirrje Tre-Drejtimëshe

| Detyrë                                                                                        | Buton | Përdorimi                                    |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------|-------|----------------------------------------------|
| Mbani në linjë thirrjen aktuale dhe pranoni një telefonatë hyrëse                             | MFB   | Shtypje e vetme                              |
| Mbani në linjë thirrjen aktuale dhe refuzoni një telefonatë hyrëse                            | MFB   | Shtypni dhe mbajeni të shtypur për 1 sekondë |
| Manovroni duke kaluar ndërmjet telefonatës së dy- drejtimëshe dhe telefonatës tre-drejtimëshe | MFB   | Shtypje e vetme                              |

## Asistenti zazor

| Detyrë                                            | Buton | Përdorimi        |
|---------------------------------------------------|-------|------------------|
| "Asistenti i aktivizimit të zërit" (Siri/ Google) | MFB   | Shtyp dy herë    |
| Ndalo "Asistentin Zazor"                          | MFB   | Shtypni një herë |

## Statusi i treguesit LED të kufjeve

| Statusi i kufjeve                                                        | Treguesi                                                                       |
|--------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------|
| Kufjet janë të lidhura me një pajisje Bluetooth                          | Driita LED blu pulson çdo 2 sekonda                                            |
| Kufjet janë gati për çiftim                                              | LED pulson në ngjyrë blu dhe të bardhë në mënyrë alternative                   |
| Kufjet janë të ndezura, por nuk janë të lidhura me një pajisje Bluetooth | LED i bardhë pulson një herë në 7 sekonda (fiket automatikisht pas 5 minutash) |
| Po karikon                                                               | LED i bardhë do të jetë i ndezur                                               |
| Karikimi përfundoi                                                       | LED i bardhë do të fiket                                                       |
| Bateri e ulët                                                            | LED i bardhë do të pulsojë ngadalë çdo 5 sekonda                               |
| Gabim në karikim                                                         | LED i bardhë pulson shpejt çdo 1 sekondë                                       |
| Ndezja                                                                   | LED i bardhë do të jetë i ndezur për 2 sekonda                                 |
| Fikja                                                                    | LED i bardhë do të jetë i ndezur për 3 sekonda                                 |

## 5 Rivendosni kufjet

Nëse hasni ndonjë problem çiftimi ose lidhjeje, ju mund të ndiqni procedurën e mëposhtme për të rivendosur kufjet në cilësimet e paracaktuara të fabrikës.

- 1 Në pajisjen tuaj Bluetooth, shkoni te menyuja Bluetooth dhe hiqni **Philips TAH8000E** nga lista e pajisjeve.
- 2 Fikni funksionin Bluetooth të pajisjes suaj Bluetooth.
- 3 Ndizni kufjet.
- 4 Shtypni dhe mbani shtypur butonin e ndezjes dhe butonin ANC për 4 sekonda në të njëjtën kohë.
- 5 Ndiqni hapat e përshkruar në "Përdorni kufjet tuaja - lidhni kufjet me pajisjen tuaj Bluetooth".
- 6 Çiftoni kufjet me pajisjen tuaj Bluetooth, zgjidhni **Philips TAH8000E**.

## 6 Të dhënat teknike

- Koha e riprodhimit të muzikës:
  - 70 orë përdorim (me anulim aktiv të zhurmës (ANC) të fikur)
  - 50 orë përdorim (me anulim aktiv të zhurmës (ANC) të ndezur)
- Koha e karikimit: 2 orë
- Bateri litium-jon e rikarikueshme: TACR0001BA (1100 mAh)
- Versioni i Bluetooth: 5.4
- Profilet e përputhshme Bluetooth:
  - HFP (Profil pa përdorimin e duarve)
  - A2DP (Profil i përparuar i shpërndarjes së audios)
  - AVRCP (Profil i telekomandës audio video)
- Kodekët e mbështetur të audios: SBC, AAC, LDAC, LC3
- Rrezja e frekuencës: 2,4-2,4835 GHz
- Fuqia e transmetuesit: < 10 dBm
- Rrezja e veprimit: Deri në 10 metra
- Fikja automatike e mbyllur
- Portë USB-C për karikim
- Lidhje me shumë pika



### Shënim

- Specifikimet mund të ndryshojnë pa paralajmërim.
- Kohëzgjatja e baterisë gjatë kohës së riprodhimit është e përafërt dhe mund të ndryshojë në varësi të kushteve të aplikimit.

# 7 Njoftim

## Deklarata e konformitetit

Nëpërmjet këtij dokumenti, TP Vision Europe B.V. deklaron se produkti është në përputhje me kërkesat bazë dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës RED 2014/53/EU dhe UK Radio Equipment Regulations SI 2017 No 1206. Deklarata e Konformitetit mund të gjendet në [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support).

## Asgjësimi i produktit dhe baterisë tuaj të vjetër



Produkti juaj është konceptuar dhe prodhuar me materiale dhe përbërës të cilësisë së lartë, të cilët mund të riciklohen dhe ripërdoren.



Ky simbol në një produkt do të thotë që produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.




Ky simbol nënkupton se produkti përmban bateri të mbuluara nga Rregullorja Evropiane (EU) 2023/1542, të cilat nuk mund të hidhen me mbeturinat e zakonshme shtëpiake. Informohuni për sistemin lokal të grumbullimit të veçantë për produktet dhe bateritë elektrike dhe elektronike. Ndiqni rregullat lokale dhe mos e hidhni kurrë produktin dhe bateritë me mbeturinat e zakonshme shtëpiake. Asgjësimi i duhur e produkteve dhe baterive të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

## Hiqni baterinë e integruar

Nëse nuk ka sistem grumbullimi/riciklimi për produktet elektronike në vendin tuaj, mund ta mbroni mjedisin duke hequr dhe ricikluar baterinë përpara se të asgjësoni kufjet.

- Sigurohuni që kufjet të jenë shkëputur përpara se të hiqni baterinë.



## Pajtueshmëria me EMF

Ky produkt përputhet me të gjitha standardet dhe rregulloret në fuqi në lidhje me ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

## Informacion mjedisor

Janë hequr të gjitha paketimet e panevojshme. Sistemi juaj përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi respektoni rregulloret lokale në lidhje me asgjësimin e materialeve të paketimit, baterive të shtrënuara dhe pajisjeve të vjetra.

## Njoftimi i pajtueshmërisë

Pajisja përputhet me rregullat e FCC, Pjesa 15. Funkzionimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

1. Kjo pajisje mund të mos shkaktojë ndërhyrje të dëmshme dhe
2. Kjo pajisje duhet të pranojë çdo ndërhyrje të marrë, duke përfshirë ndërhyrjen që mund të shkaktojë funksionim të padëshiruar.

### Rregullat e FCC

Kjo pajisje është testuar dhe është gjetur se përputhet me kufizimet për një pajisje dixhitale të Klasit B, në përputhje me pjesën 15 të Rregullave FCC. Këto kufizime janë krijuar për të siguruar mbrojtje të arsyeshme kundër ndërhyrjeve të dëmshme në një instalim banesë. Kjo pajisje gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji radiofrekuence dhe, nëse nuk instalohet dhe përdoret në përputhje me manualin e udhëzimeve, mund të shkaktojë ndërhyrje të dëmshme në komunikimet radio. Sidoqoftë, nuk ka asnjë garanci që nuk do të ketë ndërhyrje në një instalim të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton ndërhyrje të dëmshme në marrjen e radios ose televizionit, e cila mund të përcaktohet duke fikur dhe ndezur pajisjen, përdoruesi inkurajohet të përpqet për korrigjimin e ndërhyrjes duke përdorur një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- Riorientoni ose zhvendosni antenën marrëse
- Rritni nivelin e ndarjes ndërmjet pajisjes dhe marrësit
- Futeni pajisjen në një prizë në një qark të ndryshëm nga ai me të cilin është lidhur marrësi
- Konsultohuni me tregtarin ose një teknik me përvojë radio/TV për ndihmë

### Deklarata e FCC për ekspozimin ndaj rrezatimit:

Kjo pajisje përputhet me limitet kanadeze të ekspozimit ndaj rrezatimit të përcaktuara për mjedise të pakontrolluara.

Ky transmetues nuk duhet të bashkë-vendoset ose të përdoret në lidhje me ndonjë antenë ose transmetues tjetër. Kjo pajisje duhet të instalohet dhe përdoret me një distancë minimale prej 0 mm ndërmjet radiatorit dhe trupit tuaj.

Në SHBA, kufiri i lejuar për Shkallën e Thithjes Specifike (SAR) sipas rregulloreve të FCC është 1,6 W/kg, mesatarizuar mbi një gram ind. Ky pajisje është testuar dhe plotëson standardet e pajtueshmërisë SAR të FCC. Niveli më i lartë i raportuar i SAR për përdorim pranë kokës (0 mm) është 0,058 W/kg.

**Kujdes:** Përdoruesi paralajmërohet se ndryshimet ose modifikimet që nuk miratohen shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund të anulojnë autoritetin e përdoruesit për të përdorur pajisjen.

### Kanada:

Kjo pajisje përmban transmetues / marrës të përjashtuar nga licenca që përputhen me përjashtimin nga licenca për Inovacionin, Shkencën dhe Zhvillimin Ekonomik të Kanadasë. Funkzionimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme: (1) Kjo pajisje s'mund të shkaktojë interferencë. (2) Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë, duke përfshirë edhe interferecën që mund të shkaktojë funksionim të padëshiruar të pajisjes.

CAN ICES-(B)/NMB-(B)

### Deklarata IC e ekspozimit ndaj rrezatimit:

Kjo pajisje përputhet me limitet kanadeze të ekspozimit ndaj rrezatimit të përcaktuara për mjedise të pakontrolluara.

Ky transmetues nuk duhet të bashkë-vendoset ose të përdoret në lidhje me ndonjë antenë ose transmetues tjetër.

## 8 Markat tregtare

---

### Bluetooth

Marka e fjalës dhe logot Bluetooth® janë marka tregtare të regjistruara në pronësi të Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë. Markat dhe emrat e tjerë tregtarë janë ato të pronarëve të tyre përkatës.

---

### Siri

Siri është një markë tregtare e Apple Inc., e regjistruar në SHBA dhe vende të tjera.

---

### Google

Google dhe Google Play janë marka tregtare të Google LLC.

## 9 Pyetjet e bëra shpesh

### **Kufjet e mia Bluetooth nuk ndizen.**

Niveli i baterisë është i ulët. Ngarkoni kufjet.

### **Nuk mund t'i çiftoj kufjet e mia Bluetooth me pajisjen time Bluetooth.**

Bluetooth-i është i çaktivizuar. Aktivizoni funksionin Bluetooth në pajisjen tuaj Bluetooth dhe ndizni pajisjen Bluetooth përpara se të hapni kufjet.

### **Si të rivendosni çiftimin.**

Ndërsa pajisja është e ndezur, shtypni dhe mbani shtypur butonin MFB për 5 sekonda derisa të ndizet drita LED blu. Kjo aktivizon modalitetin e riçiftimit në dy raste:

- 1) Ndërrimi i pajisjeve në modalitetin e lidhjes me shumë pika;
- 2) Lidhja nga një pajisje e re burimore.

### **Mund të dëgjoj, por nuk mund ta kontrolloj muzikën në pajisjen time Bluetooth (p.sh. luaj/pauzë/kalim përpara/prapa).**

Sigurohuni që burimi audio Bluetooth të mbështesë AVRCP (shih 'Të dhënat teknike' në faqen 12).

### **Niveli i volumit të kufjeve është shumë i ulët.**

Disa pajisje Bluetooth nuk mund të lidhin nivelin e volumit me kufjet përmes sinkronizimit të volumit. Në këtë rast, duhet të rregulloni volumnin në pajisjen tuaj Bluetooth në mënyrë të pavarur për të arritur nivelin e kërkuar të volumit.

## **Pajisja Bluetooth nuk mund t'i gjejë kufjet.**

- Kufjet mund të lidhen me një pajisje të çiftuar më parë. Fikni pajisjen e lidhur ose zhvendoseni atë jashtë rrezes së veprimit.
- Funkcioni i çiftimit mund të jetë rivendosur ose kufjet janë çiftuar më parë me një pajisje tjetër. Çiftoni sërish kufjet me pajisjen Bluetooth siç përshkruhet në manualin e përdorimit. (shihni 'Çiftoni kufjet me një pajisje tjetër Bluetooth' në faqen 8).

## **Kufjet e mia Bluetooth janë të lidhura me një telefon celular me stereo Bluetooth, por muzika luhet vetëm në autoparlantin e telefonit celular.**

Referojuni manualit të përdorimit të telefonit tuaj celular. Zgjidhni për të dëgjuar muzikë përmes kufjeve.

## **Cilësia e audios është e dobët dhe mund të dëgjohet një zhurmë kërcitjeje.**

- Pajisja Bluetooth është jashtë rrezes. Zvogëloni distancën ndërmjet kufjeve dhe pajisjes Bluetooth ose hiqni pengesat midis tyre.
- Karikoni kufjet tuaja.

## **Kryeni rregullisht pastrimin e kufjeve tuaja.**

- Përdorni një leckë të pastër dhe të lagur për të pastruar rregullisht kufjet tuaja - veçanërisht kanalet e zërit dhe vrimëzat e mikrofonit - dhe shmangni grumbullimin e substancave të tilla si djersa ose dylli i veshit.

- Nëse në kanalet e zërit, vrimat e ajrit ose vrimëzat e mikrofonit mbeten pikëza djerse ose uji, niveli i zërit do të ulet përkohësisht ose nuk do të ketë fare. Ky nuk është një keqfunksionim. Përdorni një leckë të butë dhe të lagur për të tharë plotësisht kufjet. Përndryshe, për kufjet në vesh, hiqni majat e këllëfit të kufjeve, lëvizni kanalet e zërit me drejtim nga poshtë dhe prekni lehtë kufjet rreth pesë herë mbi një leckë të thatë ose me dicka të ngjashme për të hequr ujin e mundshëm të mbledhur në brendësi.
- Sigurohuni që kufjet të jenë plotësisht të thata përpara se t'i karikoni dhe përdorni. Shmangni përdorimin e tamponëve të alkoolit me një përdorim ose të substancave të tjera për pastrim.

## **Karikoni rregullisht kufjet tuaja.**

Nëse kufjet nuk përdoren për një kohë të gjatë, bateria e ringarkueshme do të nisë të humbë ngarkesën e saj. Për të shmangur këtë humbje, jeni të lutur të karikoni plotësisht baterinë të paktën një herë në tre muaj.

Për mbështetje të mëtejshme, vizitoni [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support).



2025 © MMD Hong Kong Holding Limited. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Specifikimet mund të ndryshojnë pa paralajmërim. Philips dhe stema Philips Shield janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited ose një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi në lidhje me këtë produkt. Të gjithë emrat e tjerë të kompanive dhe produkteve mund të jenë marka tregtare të kompanive të saj përkatëse me të cilat janë të lidhura.

UM\_TAH8000E\_00\_SQ\_V1.0

